



| | | |
|---|------------|---------------------|
| REPUBLIKË KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO | | |
| KUVENDI I PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA | | |
| Dërguar më Dostavljeno | 28.04.2023 | |
| Njësi/organizација/ Org. kod. | Nr. Br. | Shtojcë - Prilog |
| 15-339105-0029701123 | | |
| PODУJEВЕ - PODUJEVO | | |



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Procesverbal i dëgjimit publik i mbajtur për Zonën Industriale

Prezent: Vigan Salihu, Drejtore i Drejtorisë për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik, DPZHE dhe Fatlum Osmani, Drejtore i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

Të hënën me 24.04.2023 në Sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur dëgjim publik lidhur me Zonën Industriale. Të pranishëm ishin Vigan Salihu, Drejtore i DPZHE-së, Fatlum Osmani, Drejtore i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe 10 qytetarë.

Drejtore Fatlum Osmani e hapi takimin duke treguar arsyen e mbajtjes së këtij takimi, që është informimi i qytetarëve, biznismenëve për themelin e Zonës Industriale. Ai tregoi se Zona Industriale do të shtrihet në pjesën e fshatit Livadicë, me afër 30ha, ashtu siç është paraparë edhe me Hartën Zonale të Komunës së Podujevës. “Ndërtimi i Zonës Industriale do të ndihmojë në zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë, duke rritur kështu mirëqenien e qytetarëve”, ka thënë Osmani.

Ai ndër të tjerash tha se arsyja e këtij takimi është të marrim edhe nga ju rekomandimet të cilat do të donit të i përfshijmë në planin e ndërtimit të Zonës Industriale. Osmani poashtu tregoj se pjesë e Zonës Industriale do të jenë vetëm bizneset prodhuese, të cilat kanë punë vetëm në ndërtimin që duhet të bëjmë për të zhvilluar biznesin e tyre.

“Jemi të hapur të dëgjojmë dhe të marrim nga ju sygjerimet të cilat i keni lidhur me Zonën Industriale. Sygjerimet e juaja mund të i paraqisni edhe përmes Zyrës Pritëse në formë të shkruar ose edhe pranë DPZHE-së”, tha Osmani.

Avni Zeqiri, përfaqësues i biznesit “AgroFrut”, kërkoj nga drejtorët të njoftohet më shumë rreth kritereve për t'u bërë pjesë e Zonës. Ai deshi të di nëse merren parasysh kriteri i qarkullimit, numri i punëtorëve apo hapësira e biznesit.

Drejtori Fatlum Osmani u përgjigj në pyetjen e Avni Zeqirit, ku tha se kriteri kryesor është të jetë biznes prodhues. “Numri i punëtorëve dhe qarkullimi nuk do të jenë kritere disfavorizuese. Askush nuk do të eleminohet për shkak të qarkullimit apo numrit të punëtorëve. Ndërsa, hapësira e biznesit në Zonën Industriale është e përcaktuar edhe me Hartën Zonale. Bizneset kanë të drejtë të ndërtojnë deri në dy kate objetet e tyre”, tha Osmani. Ai poashtu tregoj se industria ushqimore, e përpunimit, drurit, metaleve mund të jenë pjesë e Zonës.

“Për sa kohë mund të ipet në shfrytëzim hapësira në Zonën Industriale?”, pyetje Alban Shabani, qytetarë i pranishëm në diskutim.


Drejtori Fatlum Osmani u përgjigj duke treguar se deri 99 vite mund të ipet në shfrytëzim hapësira për një biznes. “Një objekt nuk mund të lihet pa shfrytëzim nga biznesi p.sh. 5 vite, mundet për një periudhë më të shkrutër kohore, por jo shumë gjatë”, u përgjigj Osmani.

Ai poashtu u bëri me dije të pranishmëve se pjesë e Zonës mund të bëhen të gjitha bizneset, jo vetëm ato vendore, sepse ideja është që të sjellim investitor, jo të pengojmë investitorë që duan të investojnë në komunën tonë.

Pasi qytetarët e pranishëm në diskutim publik për Zonën Industriale nuk kishin pyetje tjera, drejtorët e pranishëm e përmbyllën takimin duke i falenderuar të pranishmit për kohën e tyre që kanë gjetur të ishin të pranishëm në këtë diskutim. Ata thanë se janë të hapur të pranojnë qoftë pyetje, apo sygjerim, deri në kohën e themelimit të Zonës Industriale.

Procesverbalin e mbajti:

Mimozë Restelica Sejdiu



Datë: 24/04/2023



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat Publik për Zonën Industriale
Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve

| | Emri dhe mbiemri | Vendbanimi | Nënshkrimi |
|----|------------------------|-----------------|--------------------|
| 1 | LIRIDONA RRAHMANI | LLADOC | <i>Rrahy</i> |
| 2 | Filloreta Gjaku | Bajçinë | <i>Gjaku</i> |
| 3 | Mirvete Merovci - Aliu | Podujevë | <i>Merovci</i> |
| 4 | Verona Dibrani | Podujevë | <i>Verona</i> |
| 5 | Mimoza Austrati | Kërpimeli | <i>Austrati</i> |
| 6 | Blerta Ajazi | Podujevë | <i>Ajazi</i> |
| 7 | EGLON EYGOLLI | SIBOC i EPERM | <i>Eyrollli</i> |
| 8 | Allison Shabani | Kaparditë | <i>Allison</i> |
| 9 | Agan Duraku | Lipja i Poshtëm | <i>Duraku</i> |
| 10 | Huni Beqiri - Ag | Podujevë | <i>Huni Beqiri</i> |
| 11 | | | |
| 12 | | | |
| 13 | | | |
| 14 | | | |
| 15 | | | |
| 16 | | | |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |
| 23 | | | |

| | | |
|----|--|--|
| 24 | | |
| 25 | | |
| 26 | | |
| 27 | | |
| 28 | | |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |

Podujevë

24.04.2023

